



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-05  
**Vendos:** Paneli i procedurës paraprake  
Gjykatës Nikola Giju  
  
**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon  
**Parashtruesi:** Dr. Fidelma Donlon, Administratore  
**Data:** 2 tetor 2020  
**Gjuha:** Anglishte  
**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i redaktuar publik i**

**“Parashtrimi të Administratores në përputhje me rregullën 23(2) mbi masat për zbutjen e rrezikut nga KOVID-19”, parashtrimi F00015 i datës 25 shtator 2020 me një shtojcë konfidenciale**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit kujdestar për z. Salih**  
**Mustafa**  
z. Julius fon Bone

## I. HYRJE

1. Në përputhje me rregullën 23(2) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ('Rregullorja')<sup>1</sup>, Administratorja i paraqet panelit të procedurës paraprake parashtrime mbi masat për zbutjen e rrezikut nga koronavirusi ('KOVID-19'), gjatë paraqitjes së parë të të akuzuarit, z. Salih Mustafa ('z. Mustafa').

## II. HISTORIKU PROCEDURAL

2. Më 12 qershor 2020, gjykatësi i procedurës paraprake lëshoi vendimin rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*<sup>2</sup> që konfirmon akuzat kundër z. Mustafa për krime lufte në bazë të neneve 14(1)(c) dhe 16(1)(a) dhe (c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.<sup>3</sup>

3. Më 12 qershor 2020, gjykatësi i procedurës paraprake lëshoi urdhrin rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* që miratonte kërkesën e ZPS-së për fletarrestim dhe urdhër për transferim ('Vendimi për arrestim dhe transferim').<sup>4</sup>

4. Më 24 shtator 2020, ZPS-ja arrestoi z. Mustafa në Kosovë.<sup>5</sup> Pas zbatimit të urdhrin për transferim, z. Mustafa u pranua në objektin e paraburgimit më 24 shtator 2020.<sup>6</sup> Administratorja do t'ia paraqesë Gjykatësit të Procedurës Paraprake raportin mbi arrestimin dhe transferimin e z. Mustafa para paraqitjes së parë, në pajtim me Vendimin për arrestim dhe transferim.<sup>7</sup>

---

<sup>1</sup> Rregullorja e Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara, KSC-BD-03/Rev3/2020, ndryshuar më 29 dhe 30 prill 2020 ('Rregullorja').

<sup>2</sup> Vendim mbi konfirmimin e aktakuzës kundër Salih Mustafës, KSC-BC-2020-05/F00008, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*

<sup>3</sup> Ligji Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015.

<sup>4</sup> Vendim mbi kërkesën për fletarrestim dhe urdhër për transferim, KSC-BC-2020-05/F00009, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 29(a), (b).

<sup>5</sup> Njoftimi i arrestimit sipas rregullës 55(4), KSC-BC-2020-05/F00013, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>6</sup> Njoftimi i pranimit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, KSC-BC-2020-05/F00014, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

<sup>7</sup> Vendim mbi kërkesën për fletarrestim dhe urdhër për transferim, KSC-BC-2020-05/F00009, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 28.

### III. DISKUTIM

5. Ky parashtrim përmban informacion në lidhje me masat për zbutjen e rrezikut nga KOVID-19: (a) në Holandë ('shteti pritës'), me fokus të posaçëm në kufizimet e udhëtimit dhe masat për vetëkarantinë; (b) në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ('objekti i paraburgimit'), duke përfshirë edhe kohën gjatë transportimit për në mjediset e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar ('mjediset') në Raamweg 47 dhe anasjelltas; dhe (c) në sallën e gjyqit të Dhomave të Specializuara ('salla e gjyqit').

#### A. SHTETI PRITËS

6. Rregullat themelore për të gjithë në shtetin pritës janë: bëni testimin dhe qëndroni në shtëpi nëse keni simptoma të KOVID-19; qëndroni 1.5 metra larg nga njerëzit e tjerë; lani duart shpesh; kollituni dhe teshtini në bërrylin tuaj; punoni nga shtëpia nëse është e mundur; shmangni vendet me shumë njerëz; dhe udhëtoni jashtë orëve të trafikut më të dendur.<sup>8</sup> Në lidhje me ambientet e brendshme, zbatohen masat e përgjithshme të distancimit për hapësirat e brendshme: njerëzit duhet të mbajnë 1.5 distancë, për aq sa lejojnë detyrat.<sup>9</sup> Gjatë udhëtimit me automjete private me persona të familjeve të ndryshme, gjithashtu rekomandohet që të mbahet maskë jomjekësore për fytyrë.

#### 1. Kufizimet e udhëtimit për udhëtarët nga Kosova

7. Holanda ka vendosur disa kufizime për udhëtarët që vijnë nga vendet jashtë Bashkimit Evropian ('BE'). Aktualisht, Holanda dhe vendet e tjera të BE-së dhe Shengenit, si dhe Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore

---

<sup>8</sup> Masat e vendosura në shtetin pritës mund të lexohen në faqen e internetit të Qeverisë së Holandës, "Coronavirus COVID-19", <https://www.government.nl/topics/coronavirus-covid-19> (e vizituar për herë të fundit më 27 shtator 2020). Masat shtesë për rajonin e sigurisë së Hagës janë në faqen e internetit të Haaglanden Veilig, "Coronavirus COVID-19" (vetëm në holandisht), <https://haaglandenveilig.nl/coronavirus-covid-19> (e vizituar për herë të fundit më 24 shtator 2020).

<sup>9</sup> *Shih* Government of the Netherlands, "Rules that apply indoors and outdoors/Rregullat që zbatohen në ambiente të brendshme dhe të jashtme," <https://www.government.nl/topics/coronavirus-covid-19/tackling-new-coronavirus-in-the-netherlands/public-life> (e vizituar për herë të fundit më 24 shtator 2020).

(‘MB’), i kanë mbyllur kufijtë e jashtëm për njerëzit udhëtimi i të cilëve nuk është i domosdoshëm.

8. Ndalimi i udhëtimit nuk zbatohet ndër të tjerë, për personat të cilët punojnë për organizatat ndërkombëtare.<sup>10</sup> [REDAKTUAR].

## 2. Karantina për udhëtarët nga Kosova

9. Me të mbërritur në Holandë, udhëtarët nga vendet jashtë BE-së, përfshirë ata që vijnë nga Kosova, këshillohen të hyjnë në vetëkarantinë për 10 ditë.<sup>11</sup> Kjo vlen madje edhe për personat që nuk kanë simptoma, si dhe për personat që janë testuar negativ për KOVID-19, përpara ose menjëherë pas mbërritjes në Holandë.

10. [REDAKTUAR].

11. [REDAKTUAR].

12. [REDAKTUAR].

## 3. Largimi i përkohshëm nga karantina

13. Duke filluar nga 14 shtatori 2020, udhëtarë të tjerë gjithashtu lejohen të largohen nga vetëkarantina dhjetëditëshe për disa qëllime, nëse është absolutisht e domosdoshme dhe nëse nuk kanë simptoma të KOVID-19. Për shembull, udhëtarët mund të largohen nga vetëkarantina për punë të domosdoshme për organizatat ndërkombëtare të caktuara, siç janë Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar.<sup>12</sup> Përveçse për këtë qëllim specifik, udhëtarët duhet t’u binden rregullave për vetëkarantinë.

---

<sup>10</sup> *Shih* [REDAKTUAR] *shih edhe* Rijksoverheid, “Naar Nederland reizen: Ik ben een zakenreiziger/Udhëtimi në Holandë: Jam për udhëtim pune” (vetëm në holandishtë), <https://www.rijksoverheid.nl/onderwerpen/coronavirus-covid-19/reizen-en-opvakantie-gaan/buitenlandse-toeristen-naar-nederland> (e vizituar për herë të fundit më 24 shtator 2020)

<sup>11</sup> Për këshilla udhëtimi që kanë të bëjnë me Kosovën, shihni faqen e internetit të Koninkrijk der Nederlanden (në dispozicion vetëm në holandishtë), “Reisadvies Kosovo”, <https://www.nederlandwereldwijd.nl/landen/kosovo/reizen/reisadvies> (e vizituar për herë të fundit më 25 shtator 2020).

<sup>12</sup> *Shih* Government of the Netherlands, “When you don’t have to self-quarantine (stay at home) Kur nuk është e nevojshme të jeni në vetëkarantinë (të rrini në shtëpi)”, <https://www.government.nl/topics/coronavirus-covid-19/tackling-new-coronavirus-in-the->

#### 4. Masat shitesë nga 20 shtatori 2020

14. Më 18 shtator 2020, shteti pritës shpalli masa shitesë për të ndalur përhapjen e KOVID-19 në shtetin pritës, që hynë në fuqi nga 20 shtatori 2020. Që nga 20 shtatori 2020, është në fuqi ndalimi i përgjithshëm për tubime të më shumë se 50 njerëzve në hapësirë të mbyllur ose të hapur,<sup>13</sup> me disa përjashtime, përfshirë për organizatat ndërkombëtare që janë palë në një traktat me shtetin pritës.<sup>14</sup>

#### B. OBJEKTI I PARABURGIMIT

15. Mjeku i Njesisë së Paraburgimit i këshillon rregullisht Administratoren dhe shefin e paraburgimit në lidhje me masat e shëndetit publik në objektin e paraburgimit.

16. Objekti i paraburgimit gjendet në [REDAKTUAR] të shtetit pritës, PI Haaglanden ('Burgu'). [REDAKTUAR].

#### 1. Masat e shëndetit publik

17. Që nga shpërthimi i pandemisë, mjeku i Njesisë së Paraburgimit<sup>15</sup> i ka dhënë vazhdimisht këshilla [REDAKTUAR] për të ruajtur dhe promovuar shëndetin e të paraburgosurve gjatë pandemisë. [REDAKTUAR].<sup>16</sup>

18. [REDAKTUAR].

19. [REDAKTUAR].

---

[netherlands/travel-and-holidays/when-you-dont-have-to-self-quarantine](#) (e vizituar për herë të fundit më 24 shtator 2020).

<sup>13</sup> *Shih* Government of the Netherlands, "New regional measures to control the spread of coronavirus/ Masat e reja rajonale për të kontrolluar përhapjen e koronavirusit", <https://www.government.nl/latest/news/2020/09/18/new-regional-measures-to-control-the-spread-of-coronavirus> (e vizituar për herë të fundit më 24 shtator 2020).

<sup>14</sup> *Shih* Haaglanden Veilig, "Meldplicht samenkomsten meer dan 50 personen/Obligimi i lajmërimit të tubimeve me më shumë se 50 persona" (në dispozicion vetëm në holandishte), <https://haaglandenveilig.nl/meldplicht-samenkomsten-meer-dan-50-personen> (e vizituar për herë të fundit më 24 shtator 2020).

<sup>15</sup> Në rregullën 2.2 të Rregullores së Paraburgimit, "Mjeku i Njesisë së Paraburgimit" përkufizohet si: "Mjeku përgjegjës për trajtimin mjekësor në objektin e paraburgimit, zëvendësi i tij ose i saj, ose cilido mjek tjetër i emëruar nga autoritetet kompetente të shtetit pritës për trajtimin mjekësor të një të paraburgosuri".

<sup>16</sup> Shtojca 1: [REDAKTUAR].

## 2. Vizitat me të paraburgosur

20. [REDAKTUAR].

21. Në objektin e paraburgimit lejohen si vizitat përmes videolidhjes, po ashtu edhe ato personale. [REDAKTUAR<sup>17</sup>].

22. Për të mbrojtur shëndetin e të paraburgosurve dhe të tjerëve në objektin e paraburgimit, nuk lejohen më shumë se dy vizitorë të pranishëm në të njëjtën kohë në vizitë me mbrojtësin.<sup>18</sup> Mbrojtësit gjithashtu janë të obliguar t'u përgjigjen pyetjeve lidhur me shëndetin publik dhe t'i nënshtrohen kontrollit të temperaturës para se të lejohen të hyjnë në objektin e paraburgimit.<sup>19</sup> Për më tepër, mbrojtësit janë të obliguar të mbajnë pajisje mbrojtëse personale kur janë brenda objektit të paraburgimit, përfshirë kohën gjatë vizitave, të dezinfektojnë duart dhe t'u përmbahen masave të tjera higjienike, dhe të mbajnë distancë fizike të caktuar me të paraburgosurit dhe të tjerët.

23. Administratorja i ka kufizuar përkohësisht vizitat personale me anëtarë të familjes dhe vizitorë të tjerë personalë në objektin e paraburgimit. Në vend të vizitave personale, Administratorja ka autorizuar vizitat përmes videolidhjes me të afërmit e ngushtë të të paraburgosurve.<sup>20</sup>

## 3. Transportimi në seanca gjyqësore dhe anasjelltas

24. Me qëllim që të kufizohen kontaktet e jashtme, transportimi i jashtëm i të paraburgosurve kryhet vetëm në rrethana të posaçme dhe urgjente. Në rrethana të tilla, shërbimi i transportit i Shërbimit të Burgjeve të Shtetit Pritës ('DV&O') ka vendosur masa parandaluese për transportimin e të paraburgosurve në seanca gjyqësore dhe anasjelltas që janë në përputhje me masat e shtetit pritës.

---

<sup>17</sup> *Shih* Njoftimin e pranimit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, KSC-BC-2020-05/F00014, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, para. 3.

<sup>18</sup> Udhëzimi i Zyrës Administrative për kufizimet e përgjithshme mbi vizitat për shkak të COVID-19, KSC-BD-35, 23 shtator 2020, pjesa. 5.1.

<sup>19</sup> *Shih* Udhëzim i Njesisë së Paraburgimit mbi kushtet e sigurisë për hyrje në objektin e paraburgimit, KSC-BD-32, 23 shtator 2020, pjesa 11.

<sup>20</sup> Udhëzimi i Zyrës Administrative për kufizimet e përgjithshme mbi vizitat për shkak të COVID-19, KSC-BD-35, 23 shtator 2020; Udhëzimi i Zyrës Administrative për vizitat përmes videolidhjes, KSC-BD-34, 23 shtator 2020.

## 25. [REDAKTUAR].

## C. SALLA E GJYQIT

26. Në mjediset në Raamweg 47, masat për zbutjen e rrezikut janë në përputhje me masat e shtetit pritës. Për shembull, niveli i pranisë së njerëzve në ndërtesë është kufizuar për të mundësuar distancimin fizik, dhe hapësirat e përbashkëta siç janë hyrjet për personelin dhe publikun, gjithashtu janë konfiguruar për të respektuar parimin e distancimit prej 1.5 metrash. Gjithashtu, në të gjitha mjediset mund të shihen qartë udhëzimet për vendkalimet dhe pikat e pastrimit të duarve, si edhe udhëzimet për pastrim dhe pikat për pastrim në hapësirat e përbashkëta.

27. Masat për zbutjen e rrezikut në sallën e gjyqit gjithashtu janë në përputhje me masat e shtetit pritës. Ato përfshijnë masat e higjienës themelore, siç është pastrimi i duarve para hyrjes dhe daljes dhe pastrimi i pajisjeve dhe orendive para fillimit të çdo seance dhe gjatë çdo pushimi midis dy çështjeve. Personat në sallën e gjyqit do të inkurajohen që të përdorin rregullisht materialet për pastrim në secilën bankë pune.

28. Ulëset në sallën e gjyqit gjithashtu janë konfiguruar për mbajtjen e distancës fizike prej 1.5 metrash, së bashku me instalimin e mburojave prej xhami. Edhe pse planimetria e ulëseve siguron distancë fizike të përshtatshme, maskat jomjekësore të fytyrës do të sigurohen si një masë shtesë parandaluese gjatë momenteve të shkurta kur personat në sallën e gjyqit kanë nevojë të këshillohen me njëri-tjetrin.

29. Nuk ka nevojë për modifikime të bankë së gjykatësve për seanca me një gjykatës të vetëm. Po ashtu, kabinat e përkthyesve me gojë janë mjaftueshëm të gjera për mbajtjen e distancës fizike të nevojshme. Në qelitë e pritjes në Raamweg 47, është vendosur ndarje prej xhami në dhomën e vizitave të mbrojtësve.

30. Salla e gjyqit dhe objekti i paraburgimit kanë mjete teknike për të siguruar dy transmetime të njëkohshme të mbrojtura të videokonferencave në sallën e gjyqit.

31. Galeria publike është rikonfiguruar për të lejuar më së shumti deri në 20 vizitorë në ulëse dhe një karrocë invalidi. Dhoma publike e pritjes nuk do të përdoret për publikun që mbetet jashtë galerisë. Gjithashtu, hapësira për shtypin është konfiguruar

për të mbajtur më së shumti deri në 14 persona në sallën e informimit të shtypit dhe deri në 6 persona të tjerë në tryezat e punës në qendrën e medias.

32. Vizitorët në ndërtesë, përfshirë edhe mediat, duhet të regjistrohen paraprakisht dhe do t'u kërkohet që t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me shëndetin publik, para se të lejohen që të hyjnë në ndërtesë.

#### D. PARAQITJA E PARË

33. [REDAKTUAR].

34. Nëse paneli i procedurës paraprake vendos se z. Mustafa do të marrë pjesë në paraqitjen e parë përmes videokonferencës, Administratorja është e gatshme ta mundësojë videokonferencën me mjetet e nevojshme për komunikim konfidencial midis z. Mustafa dhe mbrojtësit të tij. Nëse paneli i procedurës paraprake vendos që z. Mustafa të jetë fizikisht i pranishëm në paraqitjen e parë, Administratorja është e gatshme ta mundësojë praninë fizike të z. Mustafa në sallën e gjyqit, me masat e nevojshme të sigurisë në dispozicion.

35. Kjo parashtrim dhe shtojca e tij janë protokolluar konfidencialisht në përputhje me rregullën 82(1)(b) dhe (3) të Rregullores, meqë përmbajnë të dhëna personale shëndetësore dhe të dhëna në lidhje me procedurat e Zyrës Administrative.

**Numri i fjalëve (në anglishte): 1845**

/nënshkrimi/

---

**Dr. Fidelma Donlon**

**Administratore**

E mërkurë 2 tetor 2020

Në Hagë, Holandë